

Lejet e ndërtimit

Tremujori IV, 2018

Tiranë, më 28 Shkurt 2019: Në tremujorin e katërt 2018 janë miratuar gjithsej 360 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 211 leje të miratuara në tremujorin e katërt 2017, duke shënuar një rritje prej 70,6 %.

Gjatë vitit 2018 janë miratuar gjithsej 1.194 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 819 leje të miratuara në vitin 2017, duke shënuar një rritje prej 45,8 %.

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja në tremujorin e katërt 2018 është rreth 618.219 m², nga rreth 197.130 m² miratuar në tremujorin e katërt 2017, duke shënuar një rritje me rreth 3 herë.


Gjatë vitit 2018, sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja është rreth 1.442.783 m², nga rreth 868.534 m² miratuar në vitin 2017, duke shënuar një rritje prej 66,1 %.

Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike në tremujorin e katërt 2018 është 22,1 miliardë lekë, nga 9,7 miliardë lekë miratuar në tremujorin e katërt 2017.

Ky tregues në tremujorin e katërt 2018, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, u rrit me rreth 2,3 herë.

Gjatë vitit 2018, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike është 59 miliardë lekë, nga 49,1 miliardë lekë miratuar gjatë vitit 2017, duke shënuar një rritje prej 20,1 %.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit, 2018



Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T4 – 2018

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m ²	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
Gjithsej			19.800.166	2.340.374
I. Ndërtesa	360	618.219	18.619.726	976.335
1.Ndërtime për banim (rezidente)	248	457.072	14.050.264	563.020
a. Me një kat	80	10.183	311.877	94.983
b. Me dy kate	125	25.830	880.877	284.399
c. Me tre ose më shumë kate	40	384.835	11.530.166	9.379
d. Rezidenca për komunitetet	3	36.224	1.327.344	174.259
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	112	161.147	4.569.462	413.315
a. Hotele dhe të ngjashme	21	47.613	1.471.221	2.117
b. Ndërtesa për zyra	2	186	5.284	3.335
c. Ndërtesa tregtare	29	24.590	771.406	69.548
d. Ndërtesa industriale	26	41.712	1.121.346	42.257
e. Ndërtesa të tjera	34	47.046	1.200.205	296.058
II. Punime Inxhinierike			1.180.440	1.364.039
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			259.506	1.030.243
2. Linjat e ujësjellësave,elektrike dhe telekomunikacionit			58.499	153.045
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			849.766	0
4. Punime të tjera inxhinierike			12.669	180.751

* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 17	I - 18	II - 18	III - 18	IV - 18
Shqipëria	211	221	270	343	360
Berat	6	4	8	20	12
Dibër	0	7	6	16	5
Durrës	34	23	38	51	44
Elbasan	15	19	10	30	29
Fier	35	33	32	34	30
Gjirokastër	6	4	7	13	16
Korçë	14	15	26	24	35
Kukës	2	0	1	2	3
Lezhë	6	10	18	10	19
Shkodër	23	19	14	27	29
Tiranë	64	65	99	104	120
Vlorë	6	22	11	12	18

* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja

Qarqet	IV - 17	I - 18	II - 18	III - 18	IV - 18
Shqipëria	197.130	200.944	292.895	330.725	618.219
Berat	636	539	8.868	5.702	13.571
Dibër	0	1.195	1.973	3.671	1.189
Durrës	24.036	26.068	17.634	81.802	47.154
Elbasan	15.196	6.735	2.391	8.061	16.978
Fier	6.690	16.174	11.616	26.977	6.572
Gjirokastër	3.417	6.506	1.429	2.530	6.520
Korçë	6.822	6.754	7.683	5.957	20.380
Kukës	442	0	320	2.423	740
Lezhë	1.750	1.545	3.273	3.126	14.585
Shkodër	18.779	17.384	7.322	9.123	26.211
Tiranë	115.953	103.507	214.636	165.725	456.480
Vlorë	3.409	14.537	15.750	15.628	7.839

m²

* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

Tab.4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike

Qarqet	IV - 17	I - 18	II - 18	III - 18	IV - 18
Shqipëria	9.652.046	10.213.625	11.426.712	15.240.853	22.140.540
Berat	39.278	113.402	634.464	302.057	584.440
Dibër	2.022	107.118	73.361	220.312	87.914
Durrës	1.753.404	897.135	577.965	2.700.649	2.093.900
Elbasan	643.820	265.769	715.010	1.065.704	599.773
Fier	530.694	618.398	608.423	3.159.743	1.354.519
Gjirokastër	234.714	421.983	41.217	105.838	333.949
Korçë	296.978	283.634	581.727	261.501	853.060
Kukës	24.134	0	10.554	122.175	34.626
Lezhë	109.110	48.235	82.900	212.870	495.780
Shkodër	859.968	985.424	749.499	374.712	1.039.427
Tiranë	3.919.431	3.366.997	6.762.677	6.361.955	14.329.332
Vlorë	1.238.493	3.105.530	588.915	353.337	333.820

000 / lekë

* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksioneve.

Metodologjia

Përkufizime

Leja e ndërtimit është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

Ndërtesat janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

Sipërfaqja është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

Punime Inxhinierike janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

Klienti është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.